

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kolapsi - Faza e dytë e regjistrimit/ 'Çorbë' në U-Albania, çaktivizohet opsioni i kuotave të lira
ADRESA	https://www.syri.net/sociale/916793/faza-e-dyte-e-regjistrimit-corbe-ne-u-albania-caktivizohet-opsioni-i-kuotave-te-lira/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 12:59:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 12:27:01 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	caecda9dc5c2fa463ec38badea4bfa0df3360534749eecd3a2e7efda152bf0f5
TEKSTI	619472e6a9e9c35943de9a72c741997afaafbe830d37ebda078cb7fb08b410a2
PAMJA	c64d01f66382a5edcd200dd7ccef7f44159e5b49dc96c2fbf65ddce12428f262

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	80b16d9cc7731a69e6985b55a7789cdb35fca715fc2955ccc4a76319b97e3903
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/80b16d9cc7731a69e6985b55a7789cdb35fca715fc2955ccc4a76319b97e3903>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**IRENA BEQIRAJ**Fashizmi nuk duhet kërkuar
tek revolta e protestuesve por
në Kuvend!**AGIM XHAFKA**

Dialog me mbesën



më të lexuarat

Protestë kundër bllokimit të rrugës 200-
vjeçare/ Banorët: Duan t'na marrin jetën!
Kalaja: Fushë-Kruja ndahet përgjysmëHoroskopi, 13 shtator/ Zbulo çfarë
parashikojnë yjet për secilën shenjëParashikimin e motit për sot -
Temperaturat ulen deri në 29 gradëShqipëria po përballet me çmime
ushqimore më të shtrenjta se mesatarja
europiane! TVSH-ja, ndër më të lartat në
BE'Viti i ri shikollor nis në një mjedis të
polarizuar social'/ Sindikata e Arsimit:
Politikat arsimore, të pa mjaftueshmeFaza e dytë e regjistrimit/ 'Çorbë' në U-
Albania, çaktivizohet opsioni i kuotave të
lira

Faza e dytë e regjistrimit/ 'Çorbë' në U-Albania, çaktivizohet opsioni i kuotave të lira

14:27, 15/09/2026

ZMADHO TEKSTIN**Ndërkohë që faza e dytë e regjistrimit në fakultete është drejt përfundimit, sistemi "U-Albania" është përfshirë nga një bllokim, thuajse total.**

Të dhëna të mbërritura në "Boldnews.al" dhe të verifikuara nga redaksia, tregojnë se rubrika "Kuota të Lira" është tërësisht jashtë funksionit. Gjithashtu, edhe një tjetër rubrikë, "Këndi i maturanit", gjithashtu "është i mbyllur", sipas shënimit në sistem.

Pak javë më parë, Ministria e Arsimit, Mirela Kumbaro, shprehu vlerësimin maksimal të saj dhe qeverisë që përfaqëson mbi mënyrën se si operon sistemi elektronik për regjistrimin e studentëve të rinj në Universitetet Shqiptare.

Por, situata aktuale tregon një panoramë shumë më ndryshe.

Çfarë sjell bllokimi?

Rubrika "Kuota të Lira" u jep mundësinë maturantëve, të cilët nuk janë regjistruar në fazën e parë, të zgjedhin një degë, në të cilën mund të kenë rezultuar fitues. Por, bllokimi i kësaj rubrike në sistem, i vendos kandidatët për studentë në një situatë errësire totale.

Pra, ligjërisht, ata kanë të drejtë të aplikojnë në këtë fazë të dytë, por praktikisht sistemi ua ka hequr këtë të drejtë. Ministria e Arsimit, deri në momentin e publikimit të këtij shkrimi, nuk ka dhënë asnjë sqarim për ç'akordimin e sistemit elektronik të regjistrimeve dhe as nuk është shprehur se cilat janë masat që do të merren për rikthimin e tij në funksionalitet normal.



Për momentin këndi është i mbyllur

Gjithashtu, nga Ministria e Arsimit nuk është bërë ende e ditur se çfarë do të ndodh me afatet, të cilat janë duke mbaruar, ndërkohë që kandidatët për studentë janë të privuar nga e drejta e tyre e zgjedhjes.

Afatet e regjistrimit

Procesi i regjistrimit të maturanëve që synojnë të ndjekin studimet e larta, kryhet në tre faza, nëpërmjet sistemit U-Albania.

Faza e parë shtrihet në periudhën 3 korrik deri në 9 shtator. Përgjatë kësaj kohe, maturantët regjistrohen, kryejnë pagesën e tarifës, zgjedhin 10 degë të preferuara. Më tej, procesi vijon me fazë e ankimit, regjistrimin që shtrihet në 7 faza 48-orëshe. Gjithashtu, deri në datë 9 shtator, maturantët kanë mundësi të ç'regjistrohen nga dega që kanë zgjedhur, në pritje të një alternative më të mirë që mund t'u shfaqet në fazën e dytë.



Faza e dytë shtrihet në harkun kohor nga 30 gushti në 5 tetor. Gjatë këtij afati kohor, ka disa nën-faza shumë të rëndësishme. Në datat 15-17 shtator, maturantët, të cilët nuk janë regjistruar në fazën e parë, kanë mundësinë që të përzgjedhin degët e tyre të preferuara.

Pra, janë vetëm dy ditë në dispozicionin e tyre për të bërë përzgjedhjen, gjithnjë nëpërmjet sistemit "U-Albania". Por, për të bërë këtë përzgjedhje, ata natyrisht kanë nevojë të kenë informacion mbi kuotat e lira. Këtë informacion mund ta sigurojnë vetëm tek platforma U-Albania.

Por, siç konstatoi "Boldnews.al", rubrika e "Kuotave të Lira" në sistemin e regjistrimit është tërësisht jashtë funksionit.

Redaksia, e cila ka ndjekur në vijimësi proceset e regjistrimit në universitete gjatë viteve të ndryshme, konstaton se një problematikë e tillë nuk ka ndodhur kurrë më parë.

© SYRI.net

Lexo edhe:



SYRI TV/ Fier, fshatrat e Bishanit drejt braktisjes, shkollat e mbyllura mbulohen nga ferrat



SYRI TV/ Ish-të përndjekurit vonesa me shpërblimet, Zenel Drangu: Një këst zvarritet 5 vjet



Pasojat në punë, beqarët e dashuria - Kujdes me financat sepse yjet tregohen të rezervuar

SYRI TV/ Ish-të përndjekurit vonesa me shpërblimet, Zenel Drangu: Një këst zvarritet 5 vjet

SYRI TV/ Fier, fshatrat e Bishanit drejt braktisjes, shkollat e mbyllura mbulohen nga ferrat

Viti i ri shkollor, tkurret numri i nxënësve, shpërbullimi zbrast klasat! Në Tiranë 20 shkolla vazhdojnë mësimin me turne

TË NGJASHME

SYRI TV/ Neviçishti pa nxënës, shkolla mbyll dyert, në fshat kanë mbetur vetëm të moshuar



Protestë kundër bllokimit të rrugës 200-vjeçare/ Banorët: Duan t'na marrin jetën! Kalaja: Fushë-Kruja ndahet përgjysmë

SYRI TV/ Të pamundur për të blerë mjetet mësimore, fëmijët e familjes Dopi rrezikuan shkollën



Dita e parë e shkollës në Kavajë, kryebashkiaku Fisnik Qosja mesazh urimi për të gjithë nxënësit

Viti i ri shkollor, tkurret numri i nxënësve, shpopullimi zbraz klasat! Në Tiranë 20 shkolla vazhdojnë mësimin me turne



Durrës/ Gjumnazi 'Gjergj Kastrioti' i mbyllur prej 7 vitesh! Në Fllakë fëmijët mësim në klasat pa xhama e mes ferrave

'Viti i ri shkollor nis në një mjedis të polarizuar social'/ Sindikata e Arsimit: Politikë arsimore, të pa mjaftueshme

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do t'i gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendojnë se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.